



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 90 Prot.

Tiranë, më 15 . 01 . 2024

V E N D I M

Nr. 18 , Datë 15 . 01 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 133 Regj., datë 27.06.2023, paraqitur nga subjekti ankues, K. V, kundër Spitalit Rajonal Shkodër, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e dokumentacionin e depozituar nga subjekti ankues, K. V, rezulton se ai që nga viti 2014 është i punësuar pranë Spitalit Rajonal Shkodër (SRSH) në detyrën e infermierit, pranë Shërbimit të Urgjencës/SRSH, dhe që prej datës 01.04.2022, ka mbajtur pozicionin e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës, duke ushtruar kështu të dyja detyrat njëkohësisht, si atë të infermierit dhe atë të koordinatorit.

Ankuesi shprehet se të dyja këto detyra i ka përbushur me korrektësi dhe se ka punuar me përkushtim, duke mos pasur asnjë shkelje apo masë disiplinore.

¹Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

Ankuesi parashtron se: “Me ndryshimin e titullarit të SRSH-së, më është kërkuar verbalisht dorëheqja ime nga pozicioni i koordinatorit pranë Shërbimit të Urgjencës/SRSH, për të emëruar në këtë pozicion një person tjetër. Duke mos pranuar që unë të jap dorëheqjen, titullari ka parë të arsyeshme që të bëjë lëvizjen time në detyrë dhe shpalljen e këtij pozicioni vakant. Kriteret e shpallura nga ana e Institucionit kanë qenë të qëllimshme për të favorizuar personin tjetër, pasi ato janë të njëjanshme dhe diskriminuese, haptazi favorizuese për personin tjetër, i cili nuk plotëson kriterin kryesor që për këtë pozicion pune duhet që personi i emëruar të jetë personel mjekësor (infirmier ose mjek) në Shërbimin e Urgjencës.

Punësimi i infirmierëve në institucionet shtetërore është kriter që të jenë pjesë e portalit “Infirmierë për Shqipërinë”, ku bazuar në renditjen në portal bëhet dhe emërimi sipas listëpritjes për vendet vakante në këto institucione.

SRSH haptazi ka shkelur këtë kriter duke favorizuar personin tjetër të emëruar në vendin tim, pasi personi i emëruar në këtë pozicion, pavarësisht se ka arsimin si infirmier, ai nuk e ka ushtruar asnjëherë profesionin e infirmierit dhe nuk është pjesë e portalit “Infirmierë për Shqipërinë”, dhe as nuk është pjesë e Shërbimit të Urgjencës të SRSH-së. Komisioni i ngritur për vlerësimin e kandidatëve për vendin e shpallur, kryetar i të cilit është vetë Drejtori i SRSH-së, ka treguar favorizim dhe është treguar preferencial kundrejt konkurentit tjetër”.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër dhe të ndër marrë masat efektive për të ndrequr pasojat e ardhura për shkak të veprimeve diskriminuese kundrejt tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të këtij Ligji, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe ato çështje që janë brenda afatit kohor për shqyrtim sipas parashikimeve të LMD-së.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 793/1 prot., datë 10.07.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, Spitalit Rajonal Shkodër (SRSH), si dhe dokumentacion provues, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 1933/3 prot., datë 27.07.2023, Komisioneri është njohur me qëndrimin institucional të SRSH-së, përsa i takon pretendimit të ankuesit K. V, shkresë në të cilën, ndër të tjera, citohet se:

“Z. K. V ka filluar punë pranë Spitalit Rajonal Shkodër, me detyrë Infermier, në vitin 2014.

Me shkresën me nr. 712 prot., datë 01.04.2022 është lëvizur në detyrë, nga Infermier në Shërbimin e Urgjencës, në Koordinator në po këtë Shërbim.

Me Urdhrin e Brendshëm me nr. 81, datë 12.04.2023, është ngritur Komisioni për Auditimin e zbatimit të detyrave funksionale të Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës, ku, në Relacionin me nr. 1064/1 prot., datë 13.04.2023, u evidentuan problematika si: mospërputhje dokumentacioni (kërkesë autorizim-GPS-regjistër), kërkesa pa firmën e Koordinatorit, z. V, etj.

Këto problematika janë konstatuar edhe në Raportin e Kontrollit nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Kontrollit, me nr. 1011/7 prot., datë 16.06.2023.

Me shkresën me nr. 1439 prot., datë 22.05.2023, z. V është lëvizur në detyrë nga Koordinator i Shërbimit të Urgjencës, në Infermier po pranë këtij Shërbimi, si rezultat i shkeljeve të konstatuara në Relacionin sipërcituar.

Me shkresën me nr. 1512 prot., datë 30.05.2023, nga SRSH, është bërë njoftimi i vendit vakant për pozicionin e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës.

Me Urdhrin me nr. 163, datë 19.06.2023, është ngritur Komisioni Ad-Hoc, për vlerësimin e kandidatëve që do të paraqesin kërkesa për këto pozicione pune.

Me shkresën me nr. 1704/1 prot., datë 23.06.2023, nga Komisioni Ad-Hoc është mbajtur procesverbal për shpalljen e kandidatit fitues, z. G. K, i cili me shkresën me nr. 1704/4 prot., datë 06.07.2023 është emëruar në detyrë si Koordinator pranë Shërbimit të Urgjencës/SRSH.

Sa më sipër, SRSH, ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore për lëvizjet në detyrë dhe emërimet. Kriteret e vendosura për këtë pozicion pune nuk janë diskriminuese, të njëanshme dhe favorizuese, siç pretendon ankuesi”.

Bashkëlidhur është dërguar dokumentacioni i cituar në shkresën e SRSH-së, kopje e dokumentacionit të dosjes personale të ankuesit, si dhe dosjes personale të z. G. K.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 793/2 prot., datë 18.09.2023, njoftoi dhe ftoi palët (SRSH, Operatorin e Kujdesit Shëndetësor (OKSH) dhe Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor/ DROSHK Shkodër) për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.
 3. Nëpërmjet emailit të datës 29.09.2023, DROSHKSH Shkodër ka kërkuar që seanca të shtyhet për një datë tjetër, për shkak të pamundësisë objektive të përfaqësueses ligjore të saj, për të marrë pjesë në këtë datë.
 4. Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e paraqitur, në mirëkuptim edhe të pales ankuese, u dakordësua lidhur me kërkesën për shtyrje të senacës, dhe në vijim, vendosi që seanca të zhvillohet me datë 24.10.2023, fakt i cili iu komunikua edhe palëve.
- Palëve iu është bërë e ditur se mund të depozitojnë paraprakisht ose gjatë seancës parashtrime dhe dokumenta, fakte e prova që mbështesin pretendimet e tyre.
5. Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 24.10.2023, me praninë e subjektit ankues personalisht, dhe përfaqësueses me autorizim të DSR Shkodër, juristes së DSR Shkodër³, B. B.

Palët u qëndruan të njëjtave pretendime si ato të bëra të njohura shkresërisht në ankesën e parashtrimit e depozituara prej tyre para KMD-së.

Nga ana e subjektit ankues u theksua fakti që, pretendimet e tij para KMD-së kanë të bëjnë vetëm me procedurën e ndjekur për emërimin e Koordinatorit të Urgjencës, pranë SR Shkodër, dhe jo me momentin e transferimit të tij, pasi këtë çështje e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor.

Lidhur me procedurën, pretendimet e ankuesit mbetën të njëjta, përsa i takon kriterëve të shpallura për këtë pozicion, si dhe mospërbushjes së tyre nga kandidati tjetër, i cili në përfundim të procedurës së zhvilluar nga SR Shkodër është shpallur si kandidatura fituese dhe është emëruar në pozicionin e Koordinatorit të Urgjencës, pranë SR Shkodër. Njëherësh ka ngritur edhe dyshime lidhur me favorizimin e kandidatit tjetër në testimin me shkrim, duke pretenduar se ai mund të jetë njohur paraprakisht me testin.

³ Autorizimi nr. 2781 prot., datë 23.10.2023, i DSR Shkodër.

Nga ana e përfaqësueses së SR Shkodër u theksua fakti që, kriteret e vendosura nga SR Shkodër janë kritere që janë miratuar nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH) dhe nuk janë kritere përjashtuese apo diskriminuese për ankuesin.

Po ashtu, juristja e SR Shkodër evidentoi faktin se nga ana e kandidatit tjetër G. K, në momentin e kandidimit të tij për pozicionin e shpallur vakant “Koordinator Urgjence” pranë SR Shkodër, janë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara për këtë pozicion pune. Dhe se, që në momentin e emërimit të tij në këtë pozicion e në vijim (referuar shkresës së lëshuar nga Shefi i Shërbimit të Urgjencës, depozituar në cilësi prove) G. K është i përfshirë në Planet e Punës për Stafin e Urgjencës, në Regjistrin e Urgjencës së Jashtme, ku konfirmohet se ai kryen 50% të orarit të punës në Shërbimin e Urgjencës dhe 50% në koordinimin e urgjencave mjekësore; kjo në përmbushje të detyrave funksionale të Koordinatorit të Urgjencës.

6. Në vijim të seancës dëgjimore, të dyja palët kanë dërguar argumente e dokumentacion shtesë⁴, të cilat janë depozituar në dosje, në cilësi prove.
7. Në kuadër të zbatimit të një procesi të rregullt ligjor, në zbatim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktorialitetit, Komisioneri ka njohur secilën palë respektivisht me objeksionet dhe dokumentacionin e dërguar prej palës tjetër. Dokumentacioni dhe parashtrimet e dërguara prej tyre në vijim⁵, janë depozituar pranë KMD-së në cilësi prove dhe janë analizuar gjatë kësaj vendimmarrjeje.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me punonjës të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Mirëpo, në kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien mes tij dhe punëdhënësit.

Bazuar në analizimin e fakteve, dokumentacionit të depozituar e kronologjinë e ngjarjeve, rezulton se:

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhënien e punës me Spitalin Rajonal Shkodër, me datë 30.06.2014. Në një kronologji kohore, evidentohet se:

- Me shkresën me nr. 1283 prot., datë 30.06.2014, me lëndë “Emërim provizor në detyrë”, z. K. V emërohet infermier pranë Shërbimit të Pediatriisë në vendin e znj. A. K, që ndodhet me leje lindjeje, për periudhën që ajo është me leje lindjeje.

⁴ Shkresë e protokolluar pranë KMD-së me nr. 793/3 prot., datë 06.11.2023.

⁵ Shkresë me nr. 2841/1 prot., datë 09.11.2023 e SR Shkodër. Gjithashtu janë depozituar në dosje, në cilësi prove edhe komunikimet me e-mail me palët.

- Me shkresën me nr. 1940 prot., datë 13.10.2014, të SR Shkodër, z. V, me emërim provizor pranë Shërbimit të Pediatriisë i ndërpritet marrëdhënia e punës, pasi ishte paraqitur në punë infermierja të cilën ai kishte zëvendësuar.
- Me shkresën me nr. 2443 prot., datë 09.12.2014, me lëndë “Emërim në detyrë”, z. K. V emërohet infermier i lartë pranë Shërbimit të Hemodializës, në periudhë prove tre mujore.
- Me shkresën me nr. 595 prot., datë 10.03.2015, me lëndë “Emërim definitiv në detyrë”, z. K. V, pas mbarimit me sukses të periudhës së provës, kalon në emerim definitiv si infermier i lartë pranë Shërbimit të Hemodializës, në periudhë prove tre mujore.
- Me shkresën me nr. 624 prot., datë 13.03.2015, me lëndë “Lëvizje në detyrë”, në kuadër të mirëfunksionimit të SR Shkodër, z. K. V, infermier i lartë në Shërbimin e Hemodializës kalon në Shërbimin e Reanimacionit në të njëjtin pozicion pune.
- Me shkresën me nr. 1001 prot., datë 07.05.2015, me lëndë “Lëvizje në detyrë”, z. K. V, infermier i lartë pranë Shërbimit të Reanimacionit kalon në po të njëjtin pozicion pune, në Shërbimin e Hemodializës në SR Shkodër.
- Me shkresën me nr. 1598 prot., datë 04.07.2016, me lëndë “Lëvizje në detyrë”, në kuadër të mirëfunksionimit të SR Shkodër, z. K. V, infermier i lartë në Shërbimin e Hemodializës kalon në Shërbimin e Pediatriisë.
- Me shkresën me nr. 2830 prot., datë 22.11.2016, me lëndë “Lëvizje në detyrë”, në kuadër të mirëfunksionimit të SR Shkodër, z. K. V, infermier i lartë pranë Shërbimit të Pediatriisë, me daljen në pension të K/Infermieres së Terapisë Intensive, kalon në pozicionin K/Infermier në Klinikën e Terapisë Intensive.
- Me shkresën me nr. 2909 prot., datë 16.09.2019, me lëndë “Lëvizje paralele”, z. K. V, me detyrë K/infermier në Shërbimin e Pediatriisë (Reaminacion), i cili ka qenë me kontratë me afat deri me datë 15.09.2019, në Shërbimin e Urgjencës në vend të znj. V. V, pas përfundimit të kontratës, me dëshirën e tij kalon Infermier në këtë Shërbim në vend të znj. S. M.
- Me shkresën me nr. 712 prot., datë 01.04.2022, me lëndë “Lëvizje në detyrë”, z. K. V, me detyrë infermier në Shërbimin e Urgjencës, emërohet si Koordinator në po këtë Shërbim.
- Me shkresën me nr. 221 prot., datë 05.04.2022, me lëndë “Kundërshtim vendimi” (protokolluar pranë SR Shkodër me nr. 775 prot., datë 11.04.2022) Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM), i është drejtuar SR Shkodër lidhur me kundërshtimin e tyre për lëvizjen në detyrë të z. K. V (nga Infermier në Koordinator në Shërbimin e Urgjencës), duke argumentuar mosdakordësinë e tyre, si dhe duke kërkuar kthimin e menjëhershëm në detyrën e Koordinatorit të SR Shkodër të z. G. K. QKUM nënvizon faktin se SR Shkodër nuk ka marrë miratimin/pëlqimin e QKUM, si organi përgjegjës për shërbimin e urgjencës në rang kombëtar.
- Me shkresën me nr. 1439 prot., datë 22.05.2023, me lëndë Urdhër i Brendshëm nr. 100, datë 22.05.2023 “Për lëvizje në detyrë”, z. K. V, deri më tani me detyrë Koordinator i Shërbimit të Urgjencës në Shërbimin e Urgjencës pranë SR Shkodër, i cili ka mbuluar 50% të punës si infermier pranë këtij Shërbimi dhe 50% në funksion të Koordinatorit, kalon në pozicionin infermier po pranë këtij Shërbimi. Në po të njëjtin Urdhër, në pikën 2, të tij, urdhërohet që z. V do të mbulojë pozicionin e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës në SR Shkodër deri në shpalljen e përfundimit të procedurave të vendit vakant të krijuar.

- Subjekti ankues, duke mos u dakordësuar me Urdhrin e mësipërm për lëvizjen e tij në detyrë e ka kundërshtuar atë fillimisht pranë punëdhënësit, SR Shkodër dhe më pas e ka bërë edhe objekt të shqyrtimit gjyqësor, pasi me datë 29.05.2023 ai ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, kërkesë-padinë me objekt:
“Shfuqizimin e Urdhrit nr. 100, datë 22.05.2023, të Drejtorit të SR Shkodër “Për lëvizjen në detyrë”, si akt administrativ të paligjshëm.
Detyrimin e palës së paditur (SR Shkodër dhe OSHKSH) të më rikthejë në të njëjtin pozicion pune, sipas kontratës individuale të punës, në detyrën e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës.
Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar ekzekutimin e Urdhrit nr. 100, datë 22.5.2023, si dhe çdo procedurë tjetër që lidhet me hapjen e vendeve vakante apo procedurave të tjera në lidhje me vendin e punës si Koordinator i Shërbimit të Urgjencës pranë SR Shkodër.”

Subjekti ankues, ka kërkuar pranë KMD-së se, objekt i shqyrtimit të ankesës së tij, janë vetëm pretendimet që lidhen me kriteret e shpallura nga SR Shkodër për pozicionin e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës, si dhe vlerësimin e dosjeve të dy konkurentëve nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ngritur pranë SR Shkodër.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar e vlerësuar, *së pari*, nëse vetë kriteret e shpallura për pozicionin e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës janë diferencuese apo të pafavorshme, dhe *së dyti*, nëse Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve, ka trajtuar ankuesin në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, për shkakun e pretenduar pre tij, krahasimisht me kandidatin tjetër.

Komisioneri vëren se, çdo parashtrim, dokumentacion apo fakt e provë tjetër, depozituar nga palët në mbështetje të çdo argumenti që nuk lidhet me objektin e ankesës pranë KMD-së nuk do të jetë pjesë e analizës në këtë vendim.

A/1 Lidhur me kriteret e shpallura për pozicionin Koordinator i Urgjencës pranë SR Shkodër, me datë 08.06.2023 në faqen e OSHKSH-së, dhe vlerësimin e dosjes së ankuesit nga Komisioni i Vlerësimit të SR Shkodër.

Detyrat dhe kompetencat e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe organeve në varësi përcaktohen nga VKM-ja nr. 419, datë 04.07.2018 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”*.

Në Kreun III, pika 8/ç të këtij vendimi, përcaktohet se:

“8. Drejtoritë rajonale kryejnë detyrat si më poshtë vijon:

...ç) Kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndetin publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi, trajnimi, etj) për rajonin përkatës”.

Procedurat për punësimin e punonjësve specialist deri titullar institucioni në drejtorinë qendrore të

OSHKSH, drejtoritë rajonale të OSHKSH, në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, si dhe në administratën e spitaleve rajonale e bashkiake rregullohen sipas Udhëzimit nr. 673, date 02.10.2019 “Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, Spitalet Rajonale/Bashkiake dhe NJVKSH”, të ndryshuar, të MSHMS.

Në Kreun I, pika 6, parashikohet se:

“Drejtorët e nëndrejtorët e spitaleve rajonale emërohen dhe lirohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Punonjësit e tjerë nga specialist deri në shef shërbimi emërohen nga drejtori i spitalit pasi merr miratimin për hapjen e procedurës nga drejtori i DROSHKSH”.

Shpallja e vendeve të lira të punës dhe aplikimi parashikohen në Kreun II të këtij udhëzimi, në të cilin përcaktohet se:

“1. Institucionet shëndetësore publike në varësi të OSHKSH-së identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen dhe raportojnë sipas varësisë hierarkike pranë DROSHKSH, DQOSHKSH ose MSHMS.

2. Shpallja e vendeve vakant bëhet në faqen zyrtare të DQOSHKSH, për pozicionet që janë emërtësë e ministrit dhe në faqen zyrtare të MSHMS. Gjithashtu shpallja bëhet dhe në faqen e internetit të institucionit, në rast se kanë të tillë.

3. Shpallja përmban kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pranimin, fushën e njohurive, dokumentet që duhet të dorëzohen, afatin e dorëzimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe mënyrën e komunikimit të vlerësimit”.

Në Kreun IV, pika 1, germa g) përcaktohet se:

“1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë sipas autoritetit që bën emërimin, miratohet si më poshtë:

...e) Për emërimet në pozicionin shef shërbimi dhe pozicionet e tjera të administratës në spitalet rajonalë/bashkiak, Komisioni krijohet nga DROSHKSH, kryetar i Komisionit është titullari i spitalit rajonal/bashkiak;

ndërsa në pikën 2 përcaktohen detyrat komisionit të vlerësimit si më poshtë:

- a) administron dosjet e aplikantëve;*
- b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;*
- c) përgatit pyetjet me shkrim;*
- d) bën intervistimin e kandidatëve;*
- e) bën njoftimin e kandidatëve për pikët e vlerësimit;*
- f) dërgon procesverbalet dhe materialet e tjera të konkurimit pranë njësisë së burimeve njerëzore;*
- g) dërgon tek autoriteti përgjegjës për emërimin e kandidatit fitues dhe një kopje të procesverbalit...”*

Në shtojcën 1, të kësaj VKM-je, pasqyrohet tabela me kriteret e vlerësimit të dosjes për kandidatët, si më poshtë:

Nr.	Treguesi dhe kriteret	Pikët
1.	Përvojë pune në profesion (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite eksperiencë pune)	1 - 10 pikë
2.	Nota mesatare e studimeve të larta, Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 6.00 = 2 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 7.00 = 4 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 8.00 = 6 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 9.00 = 8 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 10.00 = 10 pikë	1 -10 pikë
3.	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja të mbrojtura maksimumi = 4 pikë	0 – 4 pikë
4.	Studime shtesë deri në 4 pikë; Master profesional – 1 pikë; Master shkencor – 2 pikë; Diplomë shtesë – 4 pikë	0 – 4 pikë
5.	Trajnime dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën – maksimumi 2 pikë; a) Trajnime dhe kualifikime me kohëzgjatje dy javë deri në tre muaj – 1 pikë; b) Kualifikime nga 3 muaj e më shumë – 2 pikë	0 -2 pikë

Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i OSHKSH-ve, rregullohet sipas parashikimeve të bëra në “Rregulloren e Brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, të miratuar me Urdhrin nr. 18, datë 17.01.2019 të MSHMS.

Në nenin 14, shkronja d), të kësaj Rregulloreje, përcaktohet se, Drejtoritë Rajonale kanë si detyrë: “... d) Të kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndet publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi, trajnimi, etj) për rajonin përkatës.”

Në nenin 19 të kësaj rregulloreje përcaktohet se:

“1. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e DROSHKSH është përgjegjëse për funksionet dhe detyrat e financave, shërbimeve juridike dhe shërbimet e përgjithshme mbështetëse”, ndërsa në pikën 3 të këtij neni përcaktohen detyrat e Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të cilat janë:

a) Menaxhimi i çështjeve që lidhen me burimet njerëzore në institucionet shëndetësore të rajonit.
b) Identifikon nevojat për rekrutim për personelin mjekësor dhe stafin tjetër të të gjitha institucioneve shëndetësore të rajonit.

...

e) Organizon procedurën e rekrutimit sipas udhëzimeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për pozicionet e tjera në institucionet shëndetësore”.

Nga këqyrja e analizimi i provave e akteve të grumbulluara gjatë procesit hetimor, lidhur me kriteret e shpallura për pozicionin e koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës/SR Shkodër, Komisioneri, vëren se:

- Me lëvizjen në detyrë të ankuesit nga pozicioni i Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës në Infermier, po pranë këtij Shërbimi, dhe pas krijimit të vendit vakant, me shkresën me nr. 1512 prot., datë 30.05.2023, SR Shkodër ka paraqitur njoftimin e vendit vakant, pranë OSHKSH-së, duke përcaktuar edhe kriteret përkatëse, si më poshtë citohet:
- Kërkesë personale për pozicionin ku do të aplikohet;
- Curriculum Vitae;
- Kartë identiteti/pasaportë;
- Diploma e shkollës;
- Listë notash;
- Leje ushtrimi profesioni;
- Studime shtesë (master professional/shkencor/diplomë shtesë);
- Dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja të mbrojtura;
- Trajnime dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën;
- Librezë pune;
- Dëshmi penaliteti;
- Raport mjeko-ligjor;
- Vërtetim nga Gjykata e Rethit;
- Vërtetim nga Prokuroria e Rethit;
- Vërtetim banimi;
- Certifikatë familjare.

Me datë 08.06.2023, në faqen e OSHKSH-së, në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të VKM nr. 419, datë 04.07.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”, “Rregullores së Brendshme për Mënyrën e Funksionimit dhe Organizimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor” miratuar me Urdhër nr. 18, datë 17.01.2019 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe në zbatim Udhëzim nr. 673, datë 02.10.2019, ndryshuar me Udhëzim nr. 514, datë 18.09.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzim nr. 673, datë 02.10.2019 “Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, Spitalet Rajonale/Bashkiake dhe NJVKSH” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është njoftuar shpallja e 1 (një) vendi të lirë pune⁶ në pozicionin si vijon:

*“Spitali Rajonal Shkodër – Sektori i Urgjencës
Pozicioni: Koordinator i Shërbimit të Urgjencës I (një) punonjës.*

⁶ <https://oshksh.gov.al/njoftim-per-punesim-431/>

Aplikimet pranohen nga data data 08.06.2023 deri më datë 15.06.2023, përfshirë të dyja këto data.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë njësisë së Burimeve Njerëzore të Spitalit Rajonal Shkodër, sipas një formati i cili parashkruan të gjithë dokumentacionin në dosje të aplikantit dhe firmoset nga specialisti që merr në dorëzim kërkesën dhe aplikanti.

Procesi i rekrutimit përmban tre faza vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit:

- 1.Vlerësimi i dosjes*
- 2.Vlerësimi me shkrim*
- 3.Vlerësimi i intervistës me gojë*

Pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Vlerësimit shqyrton paraprakisht dosjet e kandidatëve duke kaluar për fazat e mëtejshme kandidatët të cilat përmbushin kriteret e përcaktuara.

Kandidatët do të njoftohen në formën e dakortësuar me email personal dhe/ose me sms në numrin e telefonit të vendosur në CV.

Në përfundim të tre fazave, shumatorja e pikëve (100 pikë) përcakton listën e fituesve sipas pozicionit të shpallur.

Çdo kandidat ka të drejtën për ankimim të procedurës jo më vonë se 48 orë nga shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur. Ankimimi depozitohet me shkrim pranë Institucionit Shëndetësor ku është kryer aplikimi për vendin e lirë të punës.

Njësia e Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe hartimin dhe arkivimin e dokumentacionit përkatës.”

Pas publikimit/shpalljes së pozicionit të mësipërm, në faqen zyrtare të OSHKSH, pranë SR Shkodër kanë aplikuar në këtë konkurim dy kandidatë: G. K dhe ankuesi, K. V.

Nëpërmjet shkresës me nr. 1639, datë 12.06.2023, G. K⁷ ka depozituar pranë Sekretarisë së SR Shkodër kërkesën dhe dokumentacionin në konkurimin për pozicionin e Koordinatorit të Urgjencës pranë Shërbimit të Urgjencës në SR Shkodër.

Nëpërmjet shkresës me nr. 1670, datë 15.06.2023, ankuesi, K. V⁸ ka depozituar pranë Sekretarisë së SR Shkodër kërkesën dhe dokumentacionin në konkurimin për të njëjtin pozicion.

⁷Sipas shkresës me nr. 1704/1 prot., datë 23.06.2023 “Procesverbal”, të SR Shkodër, depozituar në cilësi prove në dosjen e ankuesit pranë KMD-së.

⁸Sipas shkresës me nr. 1704/1 prot., datë 23.06.2023 “Procesverbal”, të SR Shkodër.

Pas aplikimit dhe paraqitjes së dokumentacionit, subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit datë 16.06.2023, i është drejtuar DQOSHKSH-së dhe SR Shkodër, ku ka ankimuar kriteret e vendosura për pozicionin e shpallur të Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës, duke evidentuar se në kriteret e shpallura duhet të cilësohet se kandidati për këtë pozicion pune, duhet të jetë personel i ekipit mjekësor të urgjencës (infirmier ose mjek), në përputhje me detyrat funksionale të Koordinatorit të Urgjencës.

Nëpërmjet shkresës me nr. 1707/1 prot., datë 19.06.2023, SR Shkodër i është përgjigjur z. V, duke argumentuar se: *“Në lidhje me ankesën tuaj për kriteret e vendosura për pozicionin Koordinator i Shërbimit të Urgjencës në SR Shkodër, ju bëj me dije se, kriteret e vendosura për këtë pozicion pune janë standarde, të përgjithshme dhe jo diskriminuese. Argumentet që paraqisni janë pjesë e detyrave që duhet të zbatojë Koordinatori i Urgjencës.”*

Me e-mailin e datës 20.06.2023, DQOSHKSH, në përgjigje të ankesës së z. V, ka argumentuar se: *“Lidhur me sa shkruani informoj se, efektivisht, në publikimin e vendit vakant në pozicionin Koordinator i Shërbimit të Urgjencës pranë SR Shkodër, datë 08.06.2023, në faqen zyrtare të OSHKSH-së, ka pasur një gabim material, lidhur me arsimin, por i gjithë përcaktimi i arsimit (gabimi material ishte Shkenca Natyrore/Infirmieri) të drejton vetëm në një format të vetëm, atë të Universitetit të Mjekësisë/Fakulteti i Shkencave Mjekësore (Infirmieri), pasi kusht primar është të ketë mbaruar studimet në Universitetin e Mjekësisë dhe së fundmi, të jetë diplomuar në degën Infirmieri.*

Gjithashtu, OSHKSH informon se në komunikimin me DROSHKSH Shkodër, rezulton se nuk ka aplikuar asnjë kandidat i diplomuar pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore, nga ku rrjedhimisht konsiderojmë që gabimi material nuk e cenon procesin.”

Nga këqyrja e-maileve të dërguara konstatohet se ndërmjet palëve, DQOSHKSH, DROSHKSH Shkodër dhe ankuesit, është komunikuar lidhur me pretendimet e ankesën e z. V për kriteret e vendosura nga ana e SR Shkodër, për të cilat ai shprehet se janë të njëanshme, diskriminuese dhe favorizuese për kandidatin tjetër.

Në e-mailin drejtuar ankuesit, SR Shkodër, në parashtrimet e veta citon ndër të tjera se⁹:

“Lidhur me pretendimin tuaj se kriteret e vendosura për pozicionin e punës Koordinator i Shërbimit të Urgjencës janë të njëanshme, diskriminuese dhe favorizuese për kandidatin tjetër, ju sqaroj se, kriteret e vendosura janë të përgjithshme, standarde dhe jodiskriminuese. Sa më sipër, nuk jemi në kushtet e diskriminimit, pasi është respektuar parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit.

⁹ Në e-mailin drejtuar KMD dhe MSHMS, dhe për dijeni: DQOSHKSH, DRPSHKSH Shkodër, dër të tjera, ankuesi shprehet se: *“Ndihej i diskriminuar jo vetëm nga favorizimi i konkurentit tjetër për këtë aplikim por edhe nga vlerësimi me 17 pikë në dosjen time, të dorëzuar për aplikim për këtë pozicion. Njoftimi i cili më ka ardhur me e-mail nuk më sqaron me detaje këtë vlerësim.*

Shpresoj një përgjigje me përparësi nga ana juaj duke qenë se ndihem i cenuar për vazhdimësinë me fazat e tjera të këtij konkursi, pasi Komisioni i vlerësimit të aplikuesve, ku kryetar është drejtori, ka shprehur qartazi preferencat dhe premimet ndaj konkurentit tjetër. Mbetem në përgjigjen tuaj për trajtimin e ankesës time, pasi do i drejtohem edhe Prokurorisë së Posaçme (SPAK) për cenimin dhe diskriminimin dhe shkeljet e bëra haptaz për këtë procedurë.”

...Theksoj se jeni trajtuar në mënyrë të njëjtë me kandidatin tjetër përsa i përket të drejtës për konkurim dhe vlerësim në këtë procedurë dhe nuk jeni në kushte më pak të favorshme sesa një person tjetër.

Përsa i përket vlerësimin të dosjes me 17 pikë, kjo është kompetencë e komisionit Ad-Hoc, vlerësimi i dokumentacionit të dosjes së çdo kandidati, sipas kriterëve të vlerësimin të përcaktuara në Udhëzimin e MSHMS, me nr. 673, datë 02.10.2019. Lidhur me sa më sipër, pretendimet tuaja nuk qëndrojnë.”

Bazuar në Urdhrin nr. 163, datë 19.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc”, të DROSHKSH Shkodër është ngritur Komisioni Ad-Hoc, i cili do të vlerësojë kandidatët që kanë paraqitur kërkesë për punësim pranë SR Shkodër, për vendin e lirë të punës në pozicionin “Koordinator i Shërbimit të Urgjencës”, në Shërbimin e Urgjencës.

Sipas Urdhrit të mësipërm, ky Komision përbëhet nga:

- Kryetar - S. H (Drejtor i SR Shkodër)
- Anëtar - E. Z (Përgjegjëse e Sek. MBNJ në DROSHKSH Shkodër)
- Anëtar - E. T (Shef Shërbimi i Urgjencës pranë SR Shkodër)

Në Urdhër përcaktohen edhe detyrat që kryen Komisioni i vlerësimin të kandidatëve, si më poshtë citohet:

- Administron dosjet e aplikantëve;
- Vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin e MSHMS me nr. 673, datë 02.10.2019;
- Përgatit pyetjet me shkrim;
- Bën intervistimin e kandidatëve;
- Bën njoftimin e kandidatëve për pikët e vlerësimin;
- Dërgon procesverbalet dhe materialet e tjera të konkurimit pranë njësisë së burimeve njerëzore;
- Dërgon tek autoriteti përgjegjës për emërim, emrin e kandidatit fitues dhe një kopje të procesverbalit.

Në vijim të procedurës lidhur me konkurimin e shpallur, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 163, datë 19.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc”, të DROSHKSH Shkodër, nga ana e Komisionit të ngritur për vlerësimin e kandidatëve, është mbajtur procesverbali i vlerësimin të tyre (Shkresa me nr. 1704/1 prot., datë 23.06.2023 e SR Shkodër), në të cilin pasqyrohet vlerësimi i kandidatëve në të tria fazat e këtij konkurimi, si më poshtë vijon:

Procesi i konkurimit

I. Faza e parë e konkurimit (Vlerësimi me dosje)

Komisioni, me datë 19.06.2023, ora 12:00, pasi u njoh dhe shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit për këtë pozicion pune, vendosi:

- Të dy kandidatët kanë plotësuar kriteret për kualifikimin në fazat e mëtejshme të konkurimit.

II. Faza e dytë e konkurimit (Provimi me shkrim)

Komisioni përgatiti pyetjet me shkrim dhe zhvilloi fazën e dytë të konkurimit me datë 22.06.2023, pra 15:00.

- K. V mori 14.4 pikë në provimin me shkrim.
- G. K mori 17 pikë në provimin me shkrim.

III. Faza e tretë e konkurimit

Pas verifikimit të dokumentacionit, testimit me shkrim, Komisioni vazhdoi me procedurën e intervistës me konkurentët e tjerë pjesëmarrës dhe u bë vlerësimi si më poshtë:

- K. V - 33.3 pikë;
- G. K - 36.3 pikë.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet i plotë vlerësimi i dy kandidatëve bazuar në kriteret e vlerësimit të kandidatëve për Koodinator të Shërbimit të Urgjencës në Shërbimin e Urgjencës në SR Shkodër:

Nr.	Emri/Mbiemri	Vlerësimi i dosjes/dokumentacionit					Testimi me shkrim	Intervista	Totali
		Nota mesatare	Studime shtesë	Përvoja	Gjuha e huaj	Trajnime të fushës			
1.	K. V (Ankuesi)	4 pikë	-	9 pikë	4 pikë	-	14,4 pikë	33,3 pikë	64,7 pikë
2.	G. K	8 pikë	4 pikë	10 pikë	-	-	17 pikë	36,3 pikë	75,3 pikë

Bazuar në pikëzimin më lart, në përfundim të vlerësimit, Komisioni vendosi shpalljen fitues të kandidatit G. K, me 75.3 pikë në total.

Bazuar në sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 1704/2 prot., datë 23.06.2023, kryetari i Komisionit Ad-Hoc, njëherësh dhe titullar i SR Shkodër, i është drejtuar DROSHKSH Shkodër më një kërkesë për miratimin e kandidatit fitues në këtë konkurim, z. G. K, në pozicionin e Koordinatorit të Urgjencës në Shërbimin e Urgjencës pranë SR Shkodër.

Me shkresën me nr. 714/5 prot., datë 03.07.2023, me lëndë “Miratim emërimi”, DROSHKSH Shkodër ka miratuar emërimin në detyrë të z. G. K, në pociozionin Koordinator të Shërbimit të Urgjencës në Shërbimin e Urgjencës pranë SR Shkodër.

Në vijim të shkresës me nr. 1704/4 prot., datë 06.07.2023 të SR Shkodër, më lëndë “Emërim në detyrë” të z. G. K, mes palëve (SR Shkodër/punëdhënës dhe G. K/punëmarrës) është nënshkruar kontrata individuale e punës (shkresa me nr. 1704/5 prot., datë 06.07.2023), sipas të cilës z. G. K emërohet në pozicionin Koordinator i Shërbimit të Urgjencës në Shërbimin/Sektorin e Urgjencës pranë SR Shkodër.

Mbështetur në legjislacionin sipërcituar, rezulton se janë drejtoritë rajonale që kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shpallin kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët.

Referuar njoftimit të datës 08.06.2023 për pozicionin Koordinator i Shërbimit të Urgjencës, në Shërbimin e Urgjencës pranë SR Shkodër, rezulton se në shpalljen e publikuar nga autoriteti përgjegjës (OSHKSH), kriteret e kërkuara janë si më poshtë:

Arsimi:

Arsim i Lartë, Universiteti i Mjekësisë/Fakulteti i Shkencave Natyrore (Infermieri). Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja:

Eksperienca në punë do të përbëjë avantazh.

Njohuri dhe aftësi:

Të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punojë në grup. I aftë të përmbushë me korrektësi dhe në kohë detyrat e ngarkuara. Bashkëpunues me të gjithë sektorët e drejtorisë si dhe shërbimin ku do të punësohet. Të njohë dhe të zbatojë dispozitat ligjore të vendosura nga QKUM. Të jetë njohës i mirë i shërbimit spitalor mbi të gjitha i shërbimit të urgjencës.

Personat e interesuar duhet të dorëzojnë CV dhe dokumentacionin përkatës sa vijon:

Kërkesë personale për pozicionin ku do të aplikojë;

Curriculum vitae;

Kartë identiteti/pasaportë (kopje);

Diploma e shkollës (kopje e noterizuar);

Listë notash (kopje e noterizuar);

Lejen e ushtrimit të profesionit;

Dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja të mbrojtura;

Trajnime dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën;

Studime shtesë (master profesional/shkencor/diplomë shtesë) (kopje e noterizuar);

Libreze pune (kopje e plotë e saj);

Referencë nga punëdhënësi i mëparshëm (nëse ka);
Vërtetim dëshmie penaliteti;
Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë;
Vërtetim nga Gjykata e Rrethit;
Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit;
Vërtetim banimi;
Çertifikatë familjare.

Bazuar në këto kritere të shpallura publikisht, kandidatët e interesuar kanë shfaqur interesin e tyre dhe kanë dorëzuar aplikimet, përfshirë këtu subjektin ankues dhe G. K.

Komisioneri vëren se, për të krijuar një panoramë krahasimore lidhur me vendosjen dhe shpalljen e kriterëve për pozicionin Koordinator i Shërbimit të Urgjencës, pranë spitaleve rajonale, ka bërë një vëzhgim në faqen zyrtare të autoritetit përgjegjës/OSHKSH-së, ku shpallen këto pozicione, dhe nga kërkimet ka rezultuar se, kriteret e vendosura dhe të shpallura për këtë pozicion pune, në të gjitha rastet kanë qenë të njëjta (duke mos specifikuar në asnjë rast, faktin se kandidati për këtë pozicion pune, paraprakisht duhet të jetë pjesë e personelit të Shërbimit të Urgjencës/mjek apo infermier.)

Kështu, për analogji, Komisioneri sjell publikimin e datës 08.03.2023, të OSHKSH-së, ku është njoftuar shpallja e 1 (një) vendi të lirë pune¹⁰ në pozicionin si vijon:
Spitali Rajonal Tepelenë - Pozicioni: Koordinator i Shërbimit të Urgjencës 1 (një) punonjës.

Kriteret e shpallura për pozicionin e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës, në SR Tepelenë janë të njëjta me kriteret e shpallura për pozicionin Koordinator i Shërbimit të Urgjencës pranë SR Shkodër.

Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se:

¹⁰ <https://oshksh.gov.al/njoftim-per-punesim-407/>

Arsimi: Arsimi i Lartë, Universiteti i Mjekësisë (Mjek/Infermier). Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Eksperienca në punë do të përbëjë avantazh.

Njohuri dhe aftësi: Të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punojë në grup. I aftë të përmbushë me korrektësi dhe në kohë detyrat e ngarkuara. Bashkëpunues me të gjithë sektorët e drejtorisë si dhe shërbimin ku do të punësohet.

Personat e interesuar duhet të dorëzojnë CV dhe dokumentacionin përkatës sa vijon: Kërkesë personale për pozicionin ku do të aplikojë; Curriculum vitae; Kartë identiteti/pasaportë (kopje); Diploma e shkollës (kopje e noterizuar); Listë notash (kopje e noterizuar); Lejen e ushtrimit të profesionit; Dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja të mbrojtura; Trajnime dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën; Studime shtesë (master profesional/shkencor/diplomë shtesë) (kopje e noterizuar); Libreze pune (kopje e plotë e saj); Referencë nga punëdhënësi i mëparshëm (nëse ka); Vërtetim dëshmie penaliteti; Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë; Vërtetim nga Gjykata e Rrethit; Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit; Vërtetim banimi; Çertifikatë familjare.

- Kriteret e vendosura dhe të shpallura (për pozicionin Koordinator i Shërbimit të Urgjencës pranë spitaleve rajonale) janë të njëjta, në të gjitha rastet, dhe procedura për vendosjen, miratimin e shpalljen e tyre, është kompetencë e DROSHKSH-ve;
- Kriteret e vendosura e të shpallura, bazuar mbi të cilat ka konkuruar ankuesi, nuk e kanë përjashtuar apo dizavantazuar atë, pasi ai i ka përmbushur ato të gjitha.
- Vlerësimi më i ulët në pikë i subjektit ankues, krahasuar me kandidatin tjetër G. K, pasqyruar në tabelën e detajuar të vlerësimit të dy kandidatëve, ka ardhur si pasojë e pikëzimit më të ulët të tij, sipas Komisionit Ad-Hoc.
- Ankuesi në tria fazat e konkurimit është vlerësuar me më pak pikë nga ana e Komisionit të vlerësimit: Në vlerësimin e dosjes ankuesi është vlerësuar me 17 pikë, ndërsa kandidati G. K, me 22 pikë; në testimin me shkrim ankuesi është vlerësuar me 14.4 pikë, ndërsa G. K, me 17 pikë; në intervistën e dhënë ankuesi është vlerësuar me 33.3 pikë, ndërsa G. K, me 36.3 pikë. Në total ankuesi ka 64.7 pikë, pra më 10.6 pikë më pak se kandidati fitues. (G. K është vlerësuar në total me 75.3 pikë).

Lidhur me pretendimin e ankuesit se kandidati G. K ka marrë më shumë pikë se ai në testimin me shkrim (17 pikë), pasi ka dyshime se i janë dhënë pyetjet përpara konkurimit, nga ana e drejtorit, Komisioneri shprehet se nuk rezulton i provuar, pasi:

- Pretendimi i ankuesit është i karakterit deklarativ dhe i pa mbështetur në ndonjë provë apo fakt që ta dëshmojë e provojë atë, e për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si provueshëm para KMD-së;
- Ankuesi është vlerësuar me më pak pikë edhe në dy fazat e tjera të konkurimit, pra, pikët e testimit me shkrim nuk kanë qenë të vetmet që e kanë penalizuar atë në pikëzimin total të tij krahasuar me G. K.
- Po ashtu, dyshimi i ngritur nga ana e ankuesit se kandidati G. K mund të mos ketë arsimimin e kualifikimin e duhur si “Infermier”, nuk qëndron, pasi bazuar në dokumentacionin e depozituar, G. K gëzon kualifikimet e kërkuara lidhur me këtë profesion, ndërsa lidhur me ushtrimin e profesionit si “infermier”, duke mbuluar 50% të orarit të punës si Koordinator i Urgjencës, Komisioneri ndjek arsyetimin se kjo hyn tek detyrat funksionale të tij, dhe për rrjedhojë duhet përmbushur gjatë ushtrimit të kësaj detyre (si Koordinator). Kështu:
- Sipas Diplomës me nr. amze/matrikullimi 737, datë 28.08.2009, të Universitetit Kristal, G. K u diplomua më datë 04.07.2009, me diplomë të nivelit të parë në Infermieri.
- Sipas Diplomës me nr. regjistri themeltar 1479-1340, datë 28.09.2012, të Universitetit Kristal, G. K, i jepet “Master i Shkencave në Menaxhimin e Shëndetit Publik, pasi përfundoi studimet e plotë universitare të ciklit të parë në Fakultetin e Infermierisë, dhe cilësohet si: Specialist i Lartë – Infermier.”
- Sipas shkresës me nr. 2519, datë 06.01.2022, “Leje për ushtrimin e profesionit”, të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, G. K, i jepet e drejta e ushtrimit të profesionit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë, me vlefshmëri deri me datë 06.11.2026.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se, në kriteret e shpalluar duhet të ishte shtuar si kriter, fakti që kandidati për Koordinator të Urgjencës pranë spitaleve rajonale, *duhet të jetë personel mjekësor e*

shërbimit të urgjencës (mjek apo infermier), dhe se ai duhet të kryejë 50% të orarit të punës aktiv në shërbimin e urgjencës si infermier dhe 50% në funksion të koordinimit, Komisioneri vlerëson se nuk është i bazuar dhe nuk qëndron pasi, ato që ankuesi i konsideron si “kritere” që duhen përmbushur, bëjnë pjesë dhe janë “detyra funksionale dhe përgjegjësi” të Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës; pra, detyra që duhen përmbushur prej koordinatorit që nga momenti i emërimit të tij në këtë detyrë e në vijim të ushtrimit të saj. Kjo gjë përcaktohet në të gjitha aktet rregullatore që përcaktojnë se cilat janë detyrat funksionale të Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës.

Bazuar në shkresën me nr. 1988/1 prot., datë 19.09.2022, “Rregullore e Brendshme e Spitalit Rajonal Shkodër”, lidhur me detyrat e përgjegjësitë e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës Mjekësore (SHUM), përcaktohet si më poshtë:

- Emërimi bëhet nga Drejtori i Spitalit;
- Koordinator i shërbimit të urgjencës mjekësore duhet të jetë personel mjekësor (mjek/infermier);
- Koordinator i shërbimit të urgjencës mjekësore është pjesë koordinuese dhe funksionale e QKUM-së;
- Realizon grafikun e punës për shoferët e autoambulancave;
- Ka varësi direkte nga shefi i shërbimit të urgjencës;
- Është pjesë e repartit të spitalit dhe bashkëpunon me shefin e repartit për mbarëvajtjen e shërbimit;
- Zbaton direktivat, urdhrat, organizimin sipas modelit të QKMU;
- Organizon, drejton dhe kontrollon punën e personelit mjekësor dhe mbështetës në bashkëpunim me njësinë e koordinimit;
- Koordinator duhet të kryejë 50% të orarit të punës aktiv në shërbimin e urgjencës dhe 50% në funksion të koordinimit;
- Njofton QKUM dhe spitalet pritëse për çdo rast të referuar nga SR Shkodër për në qendrat spitalore terciare;
- Harton grafikun e punës 24/24 orë në përputhje me Kodin e Punës, për personelin mjekësor dhe mbështetës;
- Kryen kontrollin dhe llogaritjen e kilometrave të autoambulancave sipas mbulimit me GPS;
- Kontrollon dokumentacionin përkatës, arkivimin, ruajtjen dhe raporton në mënyrë periodike njësinë e koordinimit;
- Kontrollon materialet e urgjencës, pajisjet, aparaturat, furnizimin dhe ruajtjen e medikamenteve dhe i dokumenton në një regjistër të veçantë;
- Raporton dhe bashkëpunon me shefin e shërbimit për të gjitha problemet si: furnizimi me medikamente, gjendja e aparaturave, autoambulancave, si dhe çështjet që lidhen me etikën dhe sjelljen e personelit;
- Evidenton nevojat formative specifike të personelit, bashkëpunon me spitalin përkatës dhe QKUM-në për organizimin e kurseve dhe trajnimeve.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, kandidati duhet të jetë personel mjekësor dhe se duhet të kryejë 50% të orarit të punës aktiv në shërbimin e urgjencës dhe 50% në funksion të koordinimit, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si Koordinator i Shërbimit të Urgjencës, pasi një kërkesë e tillë bën pjesë në detyrat dhe përgjegjësitë e tij si Koordinator, pasi punonjësi të jetë emëruar në këtë detyrë dhe gjatë ushtrimit të saj në vijimësi dhe nuk lidhet me plotësimin e tyre paraprak, në momentin e konkurimit për këtë pozicion. (Në këtë mënyrë, hipotetikusht do të përjashtoheshin të gjithë kandidatët që nuk janë pjesë e personeli aktual të shërbimeve të urgjencës pranë spitaleve rajonale.)

Një pretendim i tillë i ankuesit është rrëzuar edhe nga vetë organi përgjegjës që certifikon procedurën e ndjekur që nga shpallja e vendit vakant dhe deri në emërimin e kandidatit Koordinator i Shërbimit të Urgjencës, që është DROSHKSH Shkodër, i cili në përfundim të procesit të konkurimit ka miratuar emërimin e kandidatit G. K në pozicionin e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës pranë Shërbimit të Urgjencës në SR Shkodër.

Me shkresën me nr. 1704/5 prot., datë 06.07.2023, z. G. K emërohet në pozicionin Koordinator i Shërbimit të Urgjencës në Shërbimin/Sektorin e Urgjencës pranë SR Shkodër.

Bashkëlidhur shkresës me nr. 2825/4 prot., datë 06.11.2023, të Shefit të Shërbimit të Urgjencës, E. T, janë dërguar “Planet e punës të Shërbimit të Urgjencës” për muajt korrik 2023, gusht 2023, shtator 2023 dhe tetor 2023, pra për periudhën nga emërimi i tij në detyrën e Koordinatorit pranë këtij shërbimi e në vazhdimësi, ku evidentohet fakti se G. K është i përfshirë në planet e punës për stafin e Urgjencës, në Regjistrin e Urgjencës së Jashtme për muajt korrik-tetor, ku pasqyrohet dhënia e shërbimit ndaj pacientëve dhe konfirmohet që kryen 50% të orarit të punës në shërbimin e urgjencës dhe 50% të orarit në koordinimin e urgjencave mjekësore, në përmbushje të detyrave funksionale të tij si Koordinator i Shërbimit të Urgjencës.

Lidhur me këto parashtrime të depozituara nga ana e SR Shkodër, Komisioneri vlerëson se ato nuk lidhen me faktet objekt gjykimi, pasi nuk lidhen me momentin e konkurimit për pozicionin e Koordinatorit (as me momentin e shpalljes së këtij pozicioni, përfshirë edhe kriteret e shpallura, dhe as me momentin e vlerësimit të tyre nga ana e Komisionit Ad-Hoc)

Në analizë të njoftimeve të shpallura nga DQOSHKSH, për pozicione të njëjtë apo të ngjashme me pozicionin objekt shqyrtimi, rezulton se autoriteti përgjegjës për të njëjtin pozicion, për të gjitha spitalet rajonale në Shqipëri ka vendosur kriteret standard, të njëjta, të përgjithshme dhe në asnjë rast nuk evidentohet të ketë përdorur/kërkuar për tu plotësuar nga kandidatët, kriteret e pretenduara nga ankuesi.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit për favorizimin e kandidatit tjetër G. K, nga ana e drejtorit të SR Shkodër, Komisioneri vëren se nuk qëndron, bazuar në analizën si vijon:

- Vlerësimi i kandidatëve është bërë nga një Komision Ad-Hoc, i ngritur nga DROSHKSH Shkodër, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr. 163, datë 19.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc”, të DROSHKSH Shkodër;

- Vlerësimi i kandidatëve është rezultante e vlerësimeve të tre anëtarëve të këtij komisioni dhe jo vetëm e drejtorit të SR Shkodër, i cili ka të drejtën e vlerësimit për kandidatët, njëjilloj si dy anëtarët e tjerë (njëri nga të cilët nuk është pjesë e strukturës së SR Shkodër, por e DROSHKSH Shkodër);
- Pretendimi se kandidati G. K është favorizuar duke i dhënë paraprakisht pyetjet e testit me shkrim, nuk rezulton i provuar, dhe njëherësh, Komisioneri thekson se ankuesi është vlerësuar me më pak pikë në të tria fazat e konkurimit (atë me dosje dhe atë të intervistës).

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykim, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtrori e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet G. K, i janë dhënë paraprakisht pyetjet e testit me shkrim nga ana e drejtorit të SR Shkodër.

Pra, në analizë të sa më lart, Komisioneri vëren se në mungesë të provueshmërisë së deklarimeve verbale të ankuesit, ato nuk mund të merren si të mirëqena.

Komisioneri vëren se, kriteret, mënyra e vlerësimit të kandidatëve dhe e gjithë procedura e ndjekur nga ana e Komisionit Ad-Hoc, është e përcaktuar në aktin përkatës, Urdhrin nr. 163, datë 19.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc”, të DROSHKSH Shkodër, dhe është zbatuar me përpikëmeri nga ana e tij, për të dy kandidatët konkurrentë.

Ndërsa, pretendimet e ankuesit që lidhen e kanë të bëjnë me fazën e testimit e intervistimit të kandidatëve nga ana e Komisionit të Vlerësimit, në përbërje të të cilit janë edhe dy mjekë specialistë (pra, me thelbin e vlerësimit të tyre, analizimin e përmbajtjes së testit apo intervistës), Komisioneri vëren se ato janë pretendime që bazohen në elementë specifikisht të natyrës teknike dhe diskrecionale e Komisionit të Vlerësimit, (elementë të natyrës profesionale) dhe nuk mund të vlerësohen nga ana e Komisionerit.

Mosdakordësia me vlerësimin përfundimtar të Komisionit Ad-Hoc, mund të kundërshtohet nga ana e kandidatit të pakënaqur nga vlerësimi, e konkretisht nga ana e ankuesit, brenda afateve ligjore, qoftë administrativisht pranë organit përgjegjës, qoftë gjyqësisht.

Në kontekst të analizimit të fakteve sipër përmendur, Komisioneri vlerëson se kriteret e shpallura për pozicionin e Koordinatorit të Shërbimit të Urgjencës pranë Shërbimit të Urgjencës së SR Shkodër, si dhe vlerësimi i kandidatëve konkurrentë për këtë pozicion nga ana e Komisionit të Vlerësimit, nuk e ka vendosur ankuesin në kushte të pafavorshme, gjatë procedurës së konkurimit për pozicionin e Koordinatorit, dhe se, procedura e ndjekur dhe e zbatuar për sa më sipër është bërë konform praktikës së krijuar (edhe për rastet e tjera krahasimore për shpalljet e bëra në faqen e DQOSHKSH), si dhe përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore të posaçme, që rregullojnë atë.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, SR Shkodër, lidhur me procedurën e ndjekur për shpalljen e pozicionit të punës “Koordinator i Shërbimit të Urgjencës”, përfshirë këtu vendosjen e kriterëve të kërkuara për këtë pozicion, dhe më pas, vlerësimin e kandidatëve (ankuesit) nga ana e Komisionit Ad-Hoc.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm të tij, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, K. V, në fushën e punësimit, nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër, për shkak të gjendjes arsimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

